



Kohë të gjatë pa u parë me Juve profesor i nderuar Bahri, ndonëse herën e fundit jemi dëgjuar kibernetikisht. Kësohere patëm biseduar gjerë e gjatë dhe patëm realizuar njëkohësisht një intervistë po të gjatë e të thellë në internet lidhur me shumë çështje islamike dhe kombëtare shqiptare. Kjo intervistë pati influencë të madhe në opinion, duke qenë shumë mbresëlënëse njëkohësisht. Me juve "do flas", ndonëse shkurtë, këtë rast hapur, shumë miqësisht, ngase i tillë ke qenë përgjithnjë jo vetëm me neve nxënësit, por me të gjithë gjithandej. Do mëtoj të shpalos vetëm ca mbresa të mijat nga vitet e arta në medresenë Isa Beu në periudhën kohore 1984-1988.

Dorën në zemër, më duhet ta them hapur: ke qenë profesori më xhentil, më transparent dhe shumë i afërt e i hapur me gjithë nxënësit pa kurrfarë dallimi. Së këndejmi dhe lirisht mund të deklaroj se nuk ka nxënës nga medreseja që nuk ka dëgjuar me ëndje ligjëratat Tuaja dhe që nuk ka përvetësuar me një lehtësi të madhe gjitha njësitë mësimore nga lënda e akaidit, respektivisht nga apologjetika islame, njëkohësisht - profesor i së cilës ishit pikërisht Ju. Veçanërisht gjitha njësitë mësimore nga "Ilmul-Kelami": disiplinë kjo diturore islamike që vërteton çështjet besimore islame në mënyrë racionale (logjike) - i patëm "gëlltitur" me ëndje. Lëndë kjo që Ju e ligjëronit në mënyrë shumë të qartë dhe mjaftë bindëse, duke e arsyetuar me argumente nga më të ndryshmet. Personalisht dy vitet e para të medresesë isha

i përqëndruar, krahas lëndëve të tjera, më shumë në mësimin e haditheve të profetit Muhammed a.s. Përveç përvetësimit të lehtë të njëjste mësimore nga lënda e hadithit, që kësokohe na e ligjëronte profesor Muhamed ef. Aruçi (All-llahu xh.sh. e mëshiroftë!), unë pandërprerë, deri në orët e vonë të natës, kuptohet fakultativisht, merrja mësim dhe nga edukatori Hafëz Rexhep ef. Nuredini (All-llahu xh.sh. e mëshiroftë! - më vonë njashtu profesor i hadithit). Me të hyrë në vitin e tretë e të katërt, u inkuadruam në mësimin e lëndës së akaidit, të cilën Ju na e ligjëruat. Lënda e akaidit shkaktoi kthesë të madhe në ngritjen e vetëdijes islamike tek ne deri në atë shkallë sa ishim në gjendje të përballemi në debate dhe me ateistët e agnostikët më kryeneqë, që atëbotë ishin në numër shumë të madh dhe shumë aktualë për kohën. Kohë kjo kur në pothuaj komplet sistemin arsimor ish-jugosllavas dominonte ideja komunisto-ateiste, e inkorporuar në doktrinën marksist-leniniste e darviniste. Doktrinë kjo që kishte marrë dhenë gjithandej shteteve social-komuniste, duke u propaguar zhurmshëm me qëllime indoktrinuese antireligjioze. Me plot të drejtë thoshte i ndjeri Alija Izetbegoviq: "Masat e gjera popullore myslimane të paarsimuara, elita jonë e keqarsimuar". Kësokohe, jashtë medresesë, fakultativisht bisedoja me orë të tëra për çështje fikhere e akaidologjike me hoxhën zulmëmadh Idriz ef. Kakrukin, alias Idriz Kosovën (All-llahu xh.sh. e mëshiroftë!), i cili kishte fjalë miradie për Juve. Çdo të dytën javë e vizitoja në Fushë Kosovë bashkë me shokun tim Musa Vila (atëbotë nxënës i medresesë Alaudin në Prishtinë-sot profesor i hadithit në Fakultetin teologjik po në Prishtinë). Po kështu brenda medresesë bisedonim dhe me prof. Muhamed Aruçin, prof. Sherif Deharin, edukatorin Ismail Bardhi e të tjerë, por, dorën në zemër, nga Ju profesor i nderuar Bahri kemi përfituar dije të thella në lëmin e akides. Përse të tëra këto interesime e angazhime të mijat fakultative për të thelluar dijet në rrafshin e akides, të apologjetikës islame, krahas faktin që në medrese ndiqnim mësimet në mbi 20 lëndë të ndryshme fetare dhe të përgjithshme shkencore? Kjo thjesht për faktin që përmenda shkarrazi më sipër, për t'u aftësuar sa më shumë në mënyrë që të përballeshim me sukses me ato sofizmat e sofistikuara të ateistëve marksisto-leninistë e enverhoxhistë. Atëbotë vëreja që në gjitha

kontaktet e debatet e mija me njerëz të tillë kisha njohuri fare të cekëta në rrafshin fetar, e veçanërisht në rrafshin shkencor e filozofik. Së këndejmi dhe shtytja e afshi për t'u furnizuar me njohuri më të thella në gjitha lëmitë. Sikundër e dini më mirë profesor, ne nuk kemi problem fare me besimtarët tanë, të cilët në mënyrë pedante praktikojnë mësimet religjioze islame. Ne nuk kemi problem fare me frekuentuesit e rregullt të xhamive e mejtepeve. Atyre u mjaftojnë argumentet e shtjelluara ekzaktesisht nga burimet islamike: nga Kur'ani Famëlartë e nga hadithet e profetit (paqja e All-llahut qoftë me të!), pa patur nevojë të futemi thellë në argumente racionale e shkencore. Mandej, keni parasysh, kemi dhe atë anën tjetër të medaljes: poqese ngelemi vetëm në kontakt me botën e ngushtë fetare, rrezikojmë të sillemi në rreth vicioz, duke trajtuar vetëm cikërrima fetare të natyrës formalo-juridike. Apo ato temat banale disadekadëshe që shpërfaqeshin në botën tonë fetare në ato format: "T'i japim selam apo jo atij që s'ka "tërleme" (kapuç në kokë)!!!? Pranohet apo jo namazi i falur pa te mbi kokë!? e sërë dokrrash e gjepurash analoge, që për pasojë "ndryshkin" trurin e teologëve. E tillë ishte gjenerata e të jatit tim Zenelit, ndjesë pastë, i cili na shkulte flokët nëse uleshim në sofër pa kapuç. E kur pat ardhur për herë të parë të më vizitojë në medrese, s'e harroj kurrë, ofshau thellë kur ju pa juve profesorëve pa kapelë në kokë dhe murmuriti me nervozitet: "Biri im, nuk i paske fajet ti, fajet i paskan këta "të mëdhenjt!" Çdoherë kur kujtoj këtë rast, më qeshet. Herën e fundit erdha me veturë në shtëpinë Tuaj profesor i nderuar Bahri dhe u knaqëm shpirtërisht duke biseduar nën shijimin e kafesë. Çdoherë që kaloj rrugës Tetovë-Gostivar, apo anasjelltas, ndonëse rrallë, nuk lë rastin pa hyrë në Sedllarcë për të ju vizituar. Këtu veç vizitës enkas për Ju, vë në kujtesë dhe praktikën time mujore të muajit të bekuar të Ramazanit, që pata bërë në xhaminë e këtij fshati me propozimin Tuaj në këshillin arsimor të medresesë Isa Beu. Pata kaluar jashtëzakonisht bukur, në çdo pikëpamje. Ju, tok me disa profesorë të tjerë, gjithnjë insistuat që unë dhe ca medresistë të tjerë të shkëlqyeshëm të vejmë për praktikë muajve të ramazanit në xhamitë e Tetovës. Kjo për faktin se statistikisht Tetova me rrethinë zinte vendin e parë në mbarë Maqedoninë për nga dhënja e sadakatul-fitrit, zekatit dhe kurbanëve e lëkurave të tyre në fondin për

mirëmbajtjen e medresesë në Kondovë të Shkupit. Kjo, kuptohet, në saje të të dhënave të vetë Bashkësisë Islame. Së këndejmi dhe aktivizimi ynë si medresistë përgjatë ramazanit nëpër xhamitë gjithandej Maqedonisë kontribuoi shumë në ngritjen e autoritetit të medresesë Isa Beu dhe stafit të saj arsimor. Njohuritë islame dhe ato të përgjithshme që ne i thithëm nga Ju profesor i nderuar neve na bënë të aftë të tregohemi në lartësinë e detyrës përgjatë praktikave tona nëpër xhami. Më kujtohet mirë kur unë dhe nxënësi tjetër shembullor Ismet Abazi (nga Shkupi) ligjëronim në shumë xhami të Tetovës dhe orët e vona të mbrëmjes, pas teravive, merrnim pjesë aktivisht në debatet e organizuara në atë mejtepin, ta quaj lirisht historik, të Eski xhamisë. Aty merrnit pjesë aktivisht dhe Ju tok me profesor Mahir ef. Hasanin, mandej Qenan Mazllamin (një kohë kryetar i Partisë së Aksionit Demokratik), Behixhudin Shehapin, Menduh Thaqin (atëbotë absolvent në fakultet-sot kryetar i PDSH-së) dhe ca të tjerë profesionesh të ndryshme.

Profesor i nderuar Ju, si profesor dhe administrator (punëdrejtues), tok me stafin arsimor të medresesë dhe kreun e Bashkësisë Islame punuat parreshtur e me vullnet të madh në ngritjen dhe mirëmbajtjen e kësaj godine islamike. Puna juaj ishte në atë shkallë sa besimtarët myslimanë gjithandej nënqiellit tonë mbushën nga djersa e tyre përplot fondin për mirëmbajtjen e medresesë. Rrjedhimisht dhe ne, gjeneratat e para, kaluam katër vite në medrese pa paguar asnjë qindarkë për shkollimin tonë. All-llahu i Madhërishëm Ju shpërbleftë Juve dhe gjithë besimtarët për kontributin madhor në këtë rrafsh!

Çfarë do kisha vënë spikamë me këtë rast, që për mua përbën një përshtypje të jashtëzakonshme, për t'mos thënë revolucionare. Ju profesor ishit të parët, së bashku me prof. Mahir ef. Hasanin (Histori Islame, Gjuhë arabe dhe anglishte) dhe prof. Elez Ismailin (Gjuhë dhe Letërsi shqipe) që ndërmoret aksionin për t'na aftësuar në artin e të shkruarit të një artikulli apo eseje. Më kujtohet fare mirë kur në hapin e parë unë zgjedha temën "Profeti Muhammed a.s. – shembëlltyrë për mbarë njerëzimin". Me të kontrolluar të punimit tim, Ju m'u drejtuat: "Zekerija, ku i ke fusnotat? Ku e ke literaturën e konsultuar? Mbi ç'themele e prova ke shtjelluar temën?..." Unë vara krahët mbi supe në shenjë mohimi dhe stepa në vend i

memecosur. Nga këtu, madje në vijimësi të bashkëpunimit tonë në këtë rrafsh, unë fillova më seriozisht të mendoj e të merrem me përpilimin e shkrimeve të nduarnduarta. Së këndejmi, pa qëllim për t'u vetëlavdëruar, në vitin e parë në fakultet në Sarajevë në punimet seminarike që na i dha profesori dr. Fikret Karçiq (ligjërues i "Et-Tarih et-Teshri"-Historisë së të drejtës së Sheriatit), për befasinë time dhe të gjithë studentëve të tjerë, punimi im në temë "Historia dhe pasojat e Taklidit-imitimit të verbër në historinë islame", u zgjodh punimi më i mirë, të cilin mandej e lexova dhe shtjellova gojarisht para tij dhe studentëve. A të mos flasim që në lëndën e akaidit, ne të medresesë Isa Beu, e linim pa tekst profesorin dr. Mustafa Ceriq në cilëndo njësi mësimore.

Më kujtohet mirë që atëbotë Ju profesor ishit ndër të rrallët që merreshit me shkrime islamike. Emrin Tuaj e pata lexuar qysh herët në shkrime të shumta autoriale që Ju i botonit në broshurën "Edukata Islame" - revistë kjo fetare tremujore, në botim të Kryesisë së Shoqatës së Ulemave të BI në Prishtinë, mandej në përkthime të shumta shkrimesh e librash, veçanërisht në përkthimet e pjesëve të koleksionit shumëvëllimor të Buhariut.

Profesor, të mos harroj, edhe diçka kisha nënvizuar pa ekuivoqe. Duke qenë se çdo adoleshent, çdo i ri ka dëshirë të imitojë dikend në imazh, në dije e urtësi, unë personalisht për model imitimi atëbotë ju kisha Juve. Ju falënderoj nga zemra për kontributin Tuaj madhor në ngritjen dhe formimin tim fetar dhe kombëtar.

*Me selame nga zemra  
Nxënësi Juaj Zekerija Idrizi – Berlin*